



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:127021

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766416

KPPP.nr.745/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “RAFII” SH.P.K., me NUI: 810393083, me seli në rr. “Xhelal Hajda Toni”, p.nr., në Rahovec, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër debitorit “NTP Citadela” O.P., me NUI: 811640037, me seli në rr. “Ali Kelmendi”, nr.1, në Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Albana Kelmendi, avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024, të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “NTP Citadela” O.P., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.200/2024 i datës 05.04.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8%, të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “NTP Citadela” O.P., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha.

III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “RAFII” SH.P.K., ndaj debitorit “NTP Citadela” O.P., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024, sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive, si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8%, të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “RAFII” SH.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.38/18 të datës 14.02.2019, të ndryshuar sipas Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr 137/19 të datës 07.06.2021, me datën 05.04.2024 ka nxjerr Urdhrin P.nr.200/2024, me të cilin është detyruar debitori NTP Citadela” O.P., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr 137/19 të datës 07.06.2021, në afat prej 7 ditëve të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit kryesor në shumën prej 25,500.00 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale për një vit pa destinim të caktuar për periudhën nga data e paraqitjes së padisë 17.03.2011 e deri me datën 20.07.2021 kur aktgjykimi është bërë i ekzekutueshëm dhe kurse nga data 21.07.2021 e deri në pagesën definitive kamatën prej 8% në vit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,767.00 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ashtu që përmbushja e detyrimeve të debitorit ndaj kreditorit të realizohet me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen në llogari të veçantë të përmbaruesit privat, ndërsa nëse nuk ka mjete në llogaritë bankare të debitorit, atëherë përmbarimi të bëhet përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në përmbushjen e kredisë së kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se ky urdhër është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ngase dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Më tutje ka theksuar se urdhri për përmbarim nuk përmban adresën e vendbanimit, vendqëndrimi apo selisë afariste, si dhe nuk përmban objektin e përmbarimit ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të

obligohet kreditori që të paguaj shpenzimet e për përpilimin e prapësimit në shumën prej 416.00 € si dhe të gjitha shpenzimet e tjera që do të krijohen.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se propozimi për përmbarim bazohet në Aktgjykimin si titull ekzekutiv, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 07.06.2021 dhe i ekzekutueshëm me datën 20.07.2021, i cili është dorëzuar së bashku me shënimin zyrtar lidhur me plotfuqishmërinë e Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë të datës 22.02.2024. Më tutje ka deklaruar se ky urdhër përmban të gjitha elementet e parapara ligjore, përkatësisht, emrin e kreditorit, debitorit, objektin e pagesës, shumën e kredisë që duhet të realizohet, kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si dhe kopjen e vërtetuar të aktgjykimit pranë zyrës noteriale. Në lidhje me pretendimet e debitorit se urdhri përmbarim nuk përmban adresën e debitorit, e njëjta nuk qëndron për faktin se adresa është cekur si në propozim dhe me vetë faktin se debitori ka pranuar propozimin dhe se ka ushtruar prapësim, atëherë dihet edhe adresa e tij. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet si i bazuar në tërësi urdhri për përmbarim, si dhe të obligohet debitori që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8% të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore për faktin se e njëjta nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor.

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, Ae.nr 137/19, të datës 07.06.2021 debitori “NTP Citadela” është detyruar që kreditorit “Rafi” SH.P.K., të t’ia paguaj në emër të borxhit, shumën prej 25,500.00 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës, për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 17.03.2011

e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,767.00 €, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarrimor - Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr. 38/18 i datës 14.02.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, Ae.nr 137/19, të datës 07.06.2021 është i plotfuqishëm nga data 07.06.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 20.07.2021 dhe se i njëjti është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga noteri dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbarruese siç janë: *“vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv - Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument

përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që dokumenti përmbarimor, është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata shfuqizoi pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024 të Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha., sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8% të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, pasi që urdhri përmbarimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, për faktin se debitori sipas dokumentit përmbarimor është obliguar që në emër të borxhit, të ia paguaj kreditorit shumën prej 25,500.00 € me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës, për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 17.03.2011 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,767.00 €, mirëpo jo edhe kamatën ligjore prej 8 %, nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive sa i përket detyrimit kryesor dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore, andaj gjykata vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke anuluar dhe përfunduar pjesërisht urdhrin përmbarimor.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.745/24, datë 31.05.2024.

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.